



Republika e Kosovës
Republika Kosova- Kosova Cumhuriyeti

Komuna e Prizrenit
Opština Prizren – Prizren Belediyesi

Drejtoria për Urbanizëm dhe Planifikim Hapësinor
Nr: 04-351/02-127350
Dt. 24.09.2025
P r i z r e n

DREJTORATI PËR URBANIZËM dhe PLANIFIKIM HAPËSINOR, me kërkesë së **Gjevdet Gashi** nga Prizreni, me adrese në Rr.,**Faik Emrush**”, **nr.25** ne Prizren me të cilën pala ka kërkuar leje për: **Ndërtim të shtëpisë individuale** ,me autorizim avokatit Arben Shala të dt.02.08.2025 në bazë të neneve 3alineja 1 pikat 1.1,1.4,1.7 ,1.10,1.16, 1.17,1.20,1.24 dhe të nenit 4 alineja 1 pika 1.2 ,e lidhur me nenin 5 alineja 1 pika 1.1 si dhe nenit 14.alineja 1 pika 1.1 si dhe në lidhje me nenin 15 pika 1.1 dhe nenit 19. pika 2. të Ligjit për ndërtim nr.04/L-110,dhe në harmoni me dispozitat e nenit 3 alineja 1 pikat 1.1,1.3,1.5,1.6,1.7,dhe 1.8 e lidhur me nenet 4,5, dhe 9 dhe 11të Ligjit për Qendrën Historike të Prizrenit nr.04/L-066 ,si dhe Vendimit për miratimin e Planit Rregullues Urban për Konservim dhe Zhvillim të Zonës Historike të Prizrenit-Zona e Parë e Mbrojtjes nr.01/011—6604 të dt.18.12.2008 , nenit 85 të Ligjit për Vetëqeverisjen Lokale dhe të neneve 13,14,27,44,45,46,47,124 e në lidhje me nenin 125 LPA-së nr. 05/L-031, si dhe konform nenit 33 pika 13, dhe konform nenit 23 dhe 27 pika 6.1, e Rregullores për taksa Komunale nr.001/011-99275 dt.30.06.2022 si dhe Vendimit për përcaktimin e taksës administrative për lëshimin e lejes ndërtimore dhe tarifat për rregullimin e infrastrukturës në territorin e qytetit të Prizrenit nr.01/011-41141 të dt.10.04.2014, merr kete:

VENDIM
(për Leje Ndërtimore)

Kjo Leje ndërtimore i lëshohet:			
Emri:	Gjevdet Gashi nga Prizreni		
Adresa:	„Faik Emrush”, nr.25		
Telefoni:	//	Emaili:	//

Emri i projektit	Objekti – banim individual(2)		
Emri i projektuesit	“Shaip Shotka” B.I		
Adresa:	“Faik Emrush”,nr.23-Prizren		
Telefoni:	044//	Emaili:	//

Me këtë Vendim, aplikuesit për leje ndërtimore **Gjevdet Gashi** nga Prizreni, me adrese në **Rr., Faik Emrush”, nr.25** ne Prizren me të cilën pala ka kërkuar leje per: **Ndërtim të shtëpisë individuale** me etazhitet **B+P+1** në ngastrën katastrale numër **P-71813068-02281-1 Z.K.Prizren**.

	Për punët ndërtimore në vijim	
Adresa:	Prizren, Faik Emrush”, nr.25	
Zonat (t) Kadastrale	Lokacioni i ndërtimit gjendet në ë Zonën Kadastrale Prizren dhe është i destinuar zone e banimi: banim i përhershëm, etj Objekti – banim individual do të ndërtohet në parcelën P-71813068-02281-1 Z.K.Prizren me sip.191m² Etazhiteti i objektit do të jetë B+P+1 Sipërfaqja bruto e bodrumit është S=59.06m². Sipërfaqja neto e bodrumit S=49.38m² Sipërfaqja bruto e përdhësës është S=59.06m². Sipërfaqja neto e përdhësës S=49.39m² Sipërfaqja bruto e katit I është S=71.70m². Sipërfaqja neto e katit I S=61.24m² Sipërfaqja bruto e objektit është S=189.82m²(sipas lejes) Sipërfaqja neto e objektit është S=110.63m² (per pagese) Është miratuar taksa administrative për lëshimin e lejes ndërtimore në shumën prej 986.85€. Vlera e objektit sipas dokumentacionit teknik është në shumën prej 90,742.00€.	GPS Koordinatat:



Lloji i ndërtimit të propozuar:	
Ndërtimi i ri ☒	Rindërtim ☐ Ripatim ☐
Kategoria e ndërtimeve të propozuara:	
Kategoria I ☒	Kategoria II ☐
A përfshin kërkesa ndryshimin e destinimit? Po ☐ Jo ☒	
Përdorimi i propozuar i objektit- banim individual	

Me këtë vendim, poseduesit të lejes ndërtimore **Gjevdet Gashi** nga Prizreni, me adresë në **Rr., Faik Emrush**, nr.25 në Prizren me të cilën pala ka kërkuar leje për: **Ndërtim të shtëpisë individuale** me etazhitet **B+P+1** në ngastrën katastrale numër **P-71813068-02281-1 Z.K.Prizren..**

Poseduesi i Lejes Ndërtimore është i obliguar që:

- Të fillojë me punët ndërtimore brenda një (1) viti nga data e dhënies së kësaj leje ndërtimore. Në rast se nuk fillohet me ndërtim brenda këtij afati atëherë mund të bëhet kërkesa për vazhdim të lejes ndërtimore brenda afatit të vlefshmërisë së lejes ndërtimore;
- Të vendosë tabelën informuese në vendndërtim me informatat e mëposhtme:
 - Informata mbi Lejen Ndërtimore
 - Informatat mbi projektuesin
 - Informata mbi kontraktuesin
 - Prezantimi grafik i dukjes së ndërtimit
 - Të rrethoj vend ndërtimin (punishten)
- Të sigurojë që kontratkuesi në vendndërtim posedon dokumentet e mëposhtme:
 - Një kopje të kësaj leje ndërtimore;
 - Një kopje të të gjitha dokumenteve të ndërtimit që janë nënshkruar ose vulosur si të “APROVUAR” nga organi kompetent;
 - Projektin kryesor me të gjitha faza për nevoja të realizimit të ndërtimit;
 - Dokumentacionin që tregon konformitetin e produkteve të ndërtimit dhe pajisjeve me kërkesat rregullative, dhe me dokumentet e aprovuara të ndërtimit;
 - Librin dhe ditarin ndërtimor, që duhet të përmbajë regjistër të hollësishëm ditor të të gjitha punëve ndërtimore, përfshirë të dhëna të shkruara dhe skematike, që dokumentojnë: datën, vendin dhe rezultatet e testeve të kryera në materialet ose punët ndërtimore;
 - Përshkrim të problemeve të hasura gjatë ndërtimit dhe inspektimit dhe mënyrën se si janë zgjidhur si dhe;
 - Kartelën e miratuar nga Drejtoria e Inspekcionit – inspektoriat i ndërtimit e cila është e nevojshme për aplikim për certifikatë të përdorimit;
 - Të dorëzojë njoftim inspektoratit të Organit Kompetent për fillimin e ndërtimit së paku shtatë (7) ditë para fillimit të punëve ndërtimore;
 - Të njoftoj organin kompetent për të kryer inspektimet siç kërkohet me ligj, dhe akte nënligjore. Këto inspektime nuk e lirojnë aplikuesin për leje ndërtimore dhe/ose arkitektin apo inxhinierin e licencuar përgjegjës për sigurimin e inspektimeve adekuate dhe mikëqyrje ditore të punëve ndërtimore;



- Të njoftoj organin kompetent për ndryshimet në dokumentacionin ndërtimor të miratuar nga kproejktuesi. Poseduesi i Lejes Ndërtimore duhet të njoftojë organin kompetent për të gjitha ndryshimet në dokumentacionin ndërtimor të miratuara nga projektuesi përveq në rast kur:
 - o Ndryshimet nuk janë në kundërshtin me Kushtet Ndërtimore, Kodin dhe rregulloret teknike në fuqi;
 - o Ndryshimet në dimensionet e pjesëve të jashtme të ndërtimit nuk tejkalojnë 2% dhe zero presje një (0,1) metër por që nuk tejkalojnë vijën ndërtimore;
 - o Ndryshimet në organizimin e brendshëm janë në harmoni me Kushtet Ndërtimore, Kodin dhe rregulloret teknike në fuqi;
- Të aplikojë për certifikatë të përdorimit pas përfundimit të punëve ndërtimore, në pajtim me Ligjin dhe aktet nënligjore.

A r s y e t i m

Aplikuesi **Gjevdet Gashi** nga Prizreni ka kërkuar nga organi kompetent **DUPH** lëshimin e Lejes Ndërtimore për **objektin – banim individual**. Pas shqyrtimit të kërkesës dhe dokumentacionit, si dhe bazuar në Ligjin për Ndërtim Nr. 04/L-110, Ligjin Nr. 02/L-28 të Procedurës Administrative dhe dispozitat tjera të ligjit në fuqi, u konstatua se janë plotësuar të gjitha kushtet e parapara ligjore për lëshimin e Lejes Ndërtimore, andaj u vendos si në dispozitiv.

Kjo Leje Ndërtimore bazohet në shqyrtimin e provave:

- Njoftim për plotësim të dokumentacionit.
- Pëlqim për rrenimin e objektit nga DUPH.
- Pëlqimi nga “KEDS-i”.
- Pëlqimi nga Kom.”Hidroregjioni Jugor”.
- Pëlqimi nga Telekom i Kosovës – PTK-ja.
- Vertetim nga sektori i menaxhimit të mbeturinave nga DSHP.
- Vendimi i MKRS-Qendra Rajonale për Trashegimi Prizren me nr.199/4 të dt.25.07.2025 dhe rekomandimi nga KTKPQHP të dt.26.07.2025nr.50/2025
- Kater kopje të projektit kryesor dhe kopje elektronike – për Kategorinë e I

Udhëzimi juridik: pala e pakënaqur me këtë aktvendim, përmes kësaj Drejtorie me ankesë mund t’i drejtohet Ministrisë së Ambientit dhe Planifikimit Hapësinorë, brenda afatit prej 30 ditësh duke llogaritur nga dita e marrjes në dorëzim të këtij Vendimi.

DREJTORIA E URBANIZMIT DHE PLANIFIKIMIT HAPËSINOR

Nr.04-351/02-127350/Dt. 24.09.2025

Bashkepunetor profesional:

Zana Belloda inxh.dip.ark.

DREJTORI:

Pranverim Berisha,jur.